



Duke u bazuar në nenet 11 dhe 12, paragrafi 12.2 shkronja c, dhe neni 40, paragrafi 40.2, shkronja a, të ligjit për Vetëqeverisjen lokale Nr. 03/L-040 (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 6, paragrafi 5 të ligjit për Transportin Rrugor të Kosovës Nr. 04/L-179 (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2013) dhe nenit 2, të Statutit të Komunës së Shtimes Nr. 01.06/1636, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: 30.11.2018
Miratoi këtë:

RREGULLORE PËR TRANSPORTIN RRUGOR NË TERITORIN E KOMUNËS SË SHTIMES

KREU I

DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është rregullimi dhe zhvillimi i sektorit të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave në territorin e Komunës së Shtimes.

Neni 2

Fushëveprimi

Rregullorja rregullon:

- kushtet e qasjes në treg të operatoreve të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave;
- mënyrën e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave që kryhen nga operatorët e transportit - personat fizik apo juridik;
- rregullimin ose ndalimin e përdorimit të autobusëve publik në rrugë të caktuar ose rajone që kane lidhje me rrugë;
- marrja dhe zbritja e udhëtarëve dhe çështje tjera lidhur me transportin rrugor të udhëtarëve;
- krijimi dhe mbajtja (ruajtja) e regjistrave dhe inspektimi i tyre;
- transporti i bagazhit dhe mallrave tjera;
- rregullimin ose ndalimin e transportit të udhëtarëve që qëndrojnë në këmbë;
- shpejtësia maksimale të autobusëve publik;
- dizajni, pajisjet, mjetet (të brendshme ose të jashtme) të autobusëve;
- pikat e vend ndaljeve në linja për autobusë;
- rregullimin ose ndalimin e shpalljeve, shenjave dhe reklamave brenda apo jashtë autobusëve publik dhe
- rregullimin e transportit taksi.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1 **Ministria**- Ministria përkatëse për transport;
 - 1.2 **Komunë**- njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, e përcaktuar sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale;
 - 1.3 **DSHP**-Drejtoria për shërbime Publike,
 - 1.4 **Rrugë publike**- një sipërfaqe me rëndësi të përgjithshme për komunikacion, në të cilën mund të lëviz çdo kush me kushte të caktuara me ligj dhe të cilën organi kompetent e ka shpall rrugë publike;
 - 1.5 **Operator-taksi**-veprimtari e transportit të udhëtareve e cila ushtrohet nga personat fizik dhe Juridik;
 - 1.6 **Stacion i autobusëve**- objekti me infrastrukturë përcjellëse të licencuar nga Ministria me qëllim të ofrimit të shërbimeve për operatoret e transportit rrugor të udhëtareve dhe udhëtarët;
 - 1.7 **Vend-ndalje**- sipërfaqe të ndërtuara dhe të shënuara posaçërisht, e caktuar për ndaljen e autobusëve e që mundëson hyrjen, përkatësisht daljen e sigurt të udhëtarëve dhe bagazheve;
 - 1.8 **Operator i transportit**- person fizik ose juridik, vendor ose i jashtëm i cili posedon licence për kryerjen e veprimtarisë së transportit në komunikacionin rrugor;
 - 1.9 **Operat i transportit rrugor të udhëtarëve**-veprimtari e çdo operatori që vepron me anë të mjeteve motorike që janë të përshtatshme për bartjen e me shume se nëntë personave, përfshirë edhe vozitësin dhe të destinuar për këtë qëllim, shërbimet e pasagjereve për publik ose kategori të veçanta të përdoruesit në këmbim të pagesës nga personi i transportuar ose nga organizatori i transportit;
 - 1.10 **Operator transporti rrugor të mallrave**- veprimtarin e çdo operatori transportues të mallrave që kryen transport për nevoja personale dhe palë të tretë, me anë të mjeteve motorike ose mjeteve të kombinuara;
 - 1.11 **Linjë urbane periferike**- linje e cila i lidh dy e me tepër stacione, gjegjësisht vend-ndalje brenda kufijve të një Komune;
 - 1.12 **Linjë**- relacioni ose tërësia e relacioneve të kryerjes së transportit në komunikacionin rrugor, prej stacionit fillestar deri në stacionin, përkatësisht deri në vend-ndaljen përfundimtare, në të cilën transportohen udhëtarët sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe të publikuara me një ose me më shumë nisje;
 - 1.13 **Linje udhëtarësh**- linje në të cilin kryhet transportit ndërmjet stacionit fillestar dhe përfundimtar, përkatësisht vend-ndaljes së autobusëve me ndalje të detyrueshme në të gjitha stacionet, përkatësisht ven-ndaljet e autobusëve përgjatë rrugës së përcaktuar në rend të udhëtimit.

Ushtrimi i veprimtarisë së operatoreve

1. Veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallra kryhet në baze të licencës që u lëshohet operatoreve që i plotësojnë kushtet sipas Ligjit për transportin rrugor Nr.0/L-179.
2. Licenca lëshohet në vlefshmëri prej së paku pesë (5) vitesh.
3. Operatorët e transportit që kryejnë veprimtari transportit rrugor në territorin e komunës së Shtimes, janë të detyruar:
 - 3.1. të përdorin mjete të transportit, që janë teknikisht në gjendje të rregullt sipas ligjit;
 - 3.2. të mbajnë të rregullt regjistrin dhe dokumentet për çdo automjet për veprimtarinë e vet transportuese;
 - 3.3. të plotësoje evidenca statistikore, sipas formave të miratuara nga organet përkatëse dhe t'i raportojnë ato sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
 - 3.4. të mbajë dokumentet përkatëse në automjetet transportuese, të parapara sipas Ligjit për transportin rrugor.
4. Operatori i transportit rrugor, i cili bënë transportin e rregullt publik, duhet të marrë përsipër transportin e çdo udhëtar apo malli, përveç nëse nuk janë të përjashtuar nga transporti sipas rregullave të veçanta.
5. Licenca nuk është e nevojshme për automjetet e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Forcat e armatosura ndërkombëtare, Policinë e Kosovës, Ndihmës së shpejtë, Zjarrfikësve, Institucionet Publike dhe njësit e shpëtimit dhe automjetet me peshe deri në tri pike pese (3.5) tonelata apo pesha e përgjithshme nuk tejkalon gjashtë (6) tonelata.

KREU II

TRANSPORTI RRUGOR I UDHETAREVE

Neni 5

Transporti rrugor i udhëtarëve

1. Operatori i transportit rrugor të udhëtarëve nuk mund të ushtroj veprimtarin para se të pajiset me licence, leje apo rend të udhëtimit.
2. Transporti rrugor i udhëtarëve ushtrohet si :
 - 2.1.Transport i rregullt i udhëtarëve me autobus;
 - 2.2.Transport i lire i udhëtarëve;
 - 2.3.Transport taksi i udhëtarëve;
 - 2.4. Transport i veçante dhe;
 - 2.5.Transporti i udhëtarëve për nevoja vetanake.
3. Komuna është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit rrugor të udhëtarëve të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 6

Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobus

1. Transporti rrugor i udhëtarëve me autobusë, kryhet në relacione të caktuara (linja), sipas rendit të udhëtimit, të përcaktuar dhe të vërtetuar më parë, çmimit të caktuar e të shpallur dhe kushteve të tjera të transportit.
2. Transporti i rregullt i udhëtarëve mund të ushtrohet si:
 - 2.1. Transporti urban-periferik;
 - 2.2. Transporti ndër-urban;
 - 2.3. Transporti i veçante i udhëtarëve;
 - 2.4. Transporti për nevojat vetanake.
3. Transporti urban dhe urban-periferik mund të kryhet si transport i rregullt dhe i njëjti mundë të subvencionohet nga komuna.
4. Rrjeti i linjave urbane dhe urbane periferike si dhe numri i orareve në to miratohet nga organet përgjegjëse komunale.
5. Linjat të cilat lidhin dy e më tepër vendbanime në territorin e komunës, janë linja komunale.

Neni 7

Kushtet për licencimin e operatorit të transportit rrugor

1. Për marrjen e licencës së transportit rrugor të udhëtarëve, operatori duhet ti plotësoj këto kushte :
 - 1.1. Të jetë i regjistruar pranë Agjencisë për regjistrimin e bizneseve në Ministrinë përkatëse;
 - 1.2. Të ketë së paku dy automjete në pronësi të operatorit;
 - 1.3. Të ketë personel të mjaftueshëm profesional për këtë veprimtari;
 - 1.4. Ti ketë automjetet në gjendje të rregullt teknike të përcaktuara sipas ligjit dhe udhëzimeve Administrative dhe
 - 1.5. Kushtet tjera të parapara sipas Ligjit për transportin rrugor.

Neni 8

Rendi i udhëtimit

1. Me rendin e udhëtimit përcaktohen elementet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt rrugor në territorin e komunës, i cili përmban:
 - 1.1. Emërtimin e operatorit;
 - 1.2. Relacionin;
 - 1.3. Llojin e transportit;
 - 1.4. Radhitjen e vend-ndaljeve dhe largesës së tyre nga pika fillestare në Km.;
 - 1.5. Kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në çdo stacion dhe vend-ndalje;
 - 1.6. Ditët e operimit, periudha kohore në të cilën mbahet linja;
 - 1.7. Afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit.
2. Rendin e udhëtimit e lëshon DSHP-ja me vlefshmëri deri në tri vite.

3. Operatori nuk mund ta tjetërsoj e as ta japë me qira rendin e udhëtimit.
4. Transferimin e rendit të udhëtimit e bënë vetëm DSHP-ja.
5. Emri i Operatorit, i shënuar në rendin e udhëtimit, duhet të jetë i njëjtë me atë të shënuar në librezën e qarkullimit të autobusit dhe në dokumentet tjera përcjellëse të autobusit

Neni 9

Revokimi i rendit të udhëtimit

1. DSHP-ja e revokon Rendin e udhëtimit në raste kur;
 - 1.1 në afat prej 3 ditësh nga dita e fuqizimit, nuk e fillon ushtrimin e veprimtarisë;
 - 1.2 pa miratimin e DSHP-së, nuk bënë nisjen 3 here brenda një muaji kalendarik;
 - 1.3 pa miratimin e DSHP-së bënë ndërprerje të kohë pas kohëshme të mbajtjes së nisjes, respektivisht kur 12 here nuk mbanë nisjen brenda afatit të zgjatjes së rendit të udhëtimit.
2. Vendimi merret nga organi që e ka vërtetuar atë, pas dëshmisë së provave dhe argumentimit nga Inspektori i transportit rrugor.

Neni 10

Shpallja e nisjeve të lira

1. Linjat dhe nisjet e revokuara do të konsiderohen si të lira dhe të njëjtat i nënshtrohen procedurës për ndarjen e tyre.
2. Operatori i transportit është i obliguar që ndryshimin e rendit të udhëtimit, ndaljen e përkohshme apo të përhershme të transportit në linjën e lejuar, paraprakisht të miratuar nga Drejtoria, ta informoj DSHP-në apo ta shpallë përmes shtypit apo një mjeti tjetër të informimit.

Neni 11

Çmimorja

1. Çmimorja duhet të vendoset në autobus i cili qarkullon në atë linjë.
2. Personeli i autobusit merr pagesën për shërbime vetëm në baze të çmimore nga paragrafi i këtij neni.

Neni 12

Biletat

1. Çdo udhëtar duhet të pajiset me biletën në relacion të caktuar.
2. Çdo udhëtar në autobus duhet të pajiset me bilete, përveç personave me leje të veçante të caktuar me ligj. Bileta blihet në autobus apo në vende të tjera përkatëse, tek të cilat transportuesi ia ka besuar shitjen e tyre.
3. Operatori i transportit rrugor të udhëtareve, jep biletën e udhëtimit, në baze të së cilës udhëtar i fiton të drejtën për udhëtim, si dhe biletën e bagazhit, nëse paguhet kompensim i veçante për të.

Neni 13

Rregullat e mirësjelljes

Rregullat e mirësjelljes janë të rregulluara me Kodin e Mirësjelljes Nr.01/2013 për drejtuesit e automjeteve dhe personelin tjetër.

Neni 14

Transporti i veçante

1. Transport i veçante i udhëtareve është transporti i grupeve të caktuara të udhëtareve, duke përjashtuar udhëtarët e tjerë, në relacion të caktuar dhe baze të lejes së veçante.
2. Me transport të veçante të udhëtareve kryhet transporti;
 - 2.1. Nxënëseve nga vendbanimi deri te institucioni shkollor dhe anasjelltas;
 - 2.2. Punëtorëve nga vendbanimi deri në punë dhe anasjelltas;
 - 2.3. Invalidëve dhe personave me përkujdesje të veçantë.
3. Lejet për transport të veçantë lëshohen në bazë të kontratës e cila duhet të ketë:
 - 3.1. Relacionin;
 - 3.2. Listën e udhëtarëve;
 - 3.3. Çmimin e transportit;
 - 3.4. Vendet për marrje dhe zbritje të udhëtarëve;
 - 3.5. Kohën gjatë së cilës kryhet transporti.
4. Kontratën për kryerjen e transportit të veçantë e lidh operatori, i regjistruar si operator dhe porositësi i shërbimeve për grupin e udhëtarëve ku paraqitësi është njëkohësisht edhe pagesi i transportit.
5. Lejen për transport, sipas këtij neni e lëshon DSHP-ja, me pëlqimin paraprak të udhëtarëve.
6. Për lëshuarjen e Lejes për transport të nxënësve, paraprakisht kërkohet pëlqimi me shkrim i prindërve dhe pëlqimi nga Shkolla përkatëse.
7. Në vend të dukshëm të pjesës së përparme të autobusit apo mjetit tjetër me të cilin bëhet transporti i veçantë, duhet të jete mbishkrimi “Transport i veçantë”.
8. Leja për transportin e veçantë nuk mund të lëshohet pa qenë i regjistruar si operator transporti (personi fizik apo juridik).
9. Për kryerjen e këtij transporti operatori detyrohet të përdore automjete teknikisht në gjendje të rregullt.

Neni 15

Detyrimet e operatorit

1. Operatori transportues është i detyruar që transportin ta kryej në mënyrë të rregullt dhe sipas rendit të udhëtimit, të vërtetuar dhe të regjistruar nga DSHP-ja.
2. Operatori transportues është i detyruar që të shfrytëzoj stacionet e autobusëve që janë të licencuara nga Ministria dhe vend-ndaljet të cilat janë të sinjalizuara me shenja horizontale dhe vertikale të dedikuara për transport ndër-urban.
 - 2.1. Hyrja dhe ndalja e udhëtarëve bëhet vetëm në stacionet e autobusëve dhe vend ndalimet të destinuara dhe të regjistruara në rendin e udhëtimit;
 - 2.2. Operatori i transportit është i detyruar të ndalet në të gjitha vende ndaljet të cilat i ka të regjistruara në rend të udhëtimit;
3. Automjeti me të cilën kryhet transporti i rregullt i udhëtarëve duhet të ketë;
 - 3.1. Në pjesën anësore të vënë emrin e operatorit transportues të udhëtarëve;
 - 3.2. Në këndin e poshtëm të djathtë të xhamit (parafango) linjën me kohen e nisjes nga stacioni i nisjes dhe kohen e arritjes në stacionin e fundit, duke shënuar me së paku tri vend ndalje të dedikuara për marrjen dhe zbritjen e udhëtarëve;
 - 3.3. Orarin e udhëtimit , çmimoren dhe mbishkrimin mbi ndalimin e pirjes së duhanit e cila duhet të jete e vendosur në vend të dukshëm në automjet, ulëset për kategoritë e veçanta të udhëtarëve dhe shenjat e dyerve të hyrjes dhe daljes;
 - 3.4. Duhet të jete i pajisur me aparat zjarrfikës profesional;
 - 3.5. Barnatore manuale;
 - 3.6. Çekiçin për thyerjen e xhamave në rast rreziku dhe pajisje tjera.
4. Automjeti duhet të i plotësoj kushtet tekniko-eksportuese.
5. Automjeti duhet të ketë urdhërese udhëtimi, të nënshkruar dhe të plotësuar në mënyrë të rregullt.
6. Operatori i transportit i cili bënë transportin e rregullt publik në pajtim me kushtet dhe kapacitetet e disponueshme të automjeteve duhet të marrë përsipër për transportin çdo udhëtar apo mall të cilët sipas rregullave të veçanta nuk janë të përjashtuar nga transporti.
7. Operatori detyrohet që të fillon veprimtarinë e transportit të rregullt të udhëtarëve në afat prej 3 ditësh nga dita e fuqizimit të rendit të udhëtimit, dhe atë nuk mund ta ndërpresë derisa zgjate afati i rendit të udhëtimit.
8. Përjashtimisht nga paragrafi 7 i këtij neni. Operatori mund të ndërpresë përkohësisht veprimtarinë si rezultat i kushteve të jashtëzakonshme, të cilat pamundësojnë ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt.
9. Për ndërprerjen e përkohshme të veprimtarisë, nga paragrafi 7 i këtij neni, operatori është obliguar që të bëjë kërkesë në DSHP i cili do të lëshojë vendim për pranim ose refuzim të kërkesës së operatorit.
10. Pa lejen e DSHP-së, operatori nuk mund ta ndërpresë apo pezullojë veprimtarinë e transportit të rregullt në linje, sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe të vërtetuar.
11. Operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve i ndalohet vendosja e fotografive dhe objekteve të tjera me karakter pornografik.
12. Drejtuesi i automjetit është i obliguar të respektojë itinerarin e linjës, të cilin duhet t'a ketë në automjet.

13. Personeli i automjetit ka për detyrë që gjatë orarit të punës të mbaje rrobat (uniformen) zyrtare dhe ndaje udhëtarëve të ketë sjellje korrekte.

Neni 16

Transporti i Udhëtarëve me “Taksi”

1. Transporti Taksi është transporti publik i personave në transportin jo të rregullt (jashtë linjor) rrugor për të cilin çmimi për rrugën e kaluar është që me parë i njohur dhe përcaktohet në baze të taksimetrit sipas çmimoreve të shërbimeve.
2. Çmimorja duhet të jetë e vërtetuar nga organi kompetent dhe e vendosur në vend të dukshëm brenda në automjet.
3. Taksimetri duhet të jetë në gjendje të rregullt, atestuar dhe vulosur sipas kushteve të përcaktuara për taksimetër si dhe i vendosur në vend të dukshëm në automjet.
4. Transportuesi që kryen transport taksi të udhëtarëve është i detyruar të jap atij dëshminë për shërbimin e bërë e cila dëshmi përmban: regjistrimin e automjetit, relacionin, kohën e transportit, çmimin dhe nënshkrimin e transportuesit.

Neni 17

Kryerja e transportit taksi

1. Transporti taksi mund të kryhet vetëm me automjet me pesë (5) apo katër plus një (4+1) ulëse dhe i cili ka së paku katër dyer.
2. Automjeti sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk mund të ketë mjet për bartje (rimorkio ose gjysmë-rimorkio).
3. Transporti me “Auto-taksi” zhvillohet brenda territorit të komunës i cili është i regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë taksi.
4. Transporti “Auto-taksi” mund të kryhet edhe jashtë territorit të komunës, në qoftë se transporti fillon në territorin e komunës në të cilin është licencuar.
5. Transporti i udhëtarëve me taksi në linjë të rregullt është i ndaluar (linjë e rregullt është transporti i udhëtarëve me autobusë).
6. Hyrja në taksi dhe dalja nga taksi nuk mund të bëhet në vend-ndaljet (bus-stacionet).
7. Drejtuesi i automjetit taksi nuk mund të qëndroj as të marrë udhëtar në Stacionin e autobusëve në të dyja anët për gjatë rrugës në largësi prej 50-100 m.

Neni 18

Përvoja e domosdoshme e shoferit të automjetit taksi

Personat që drejtojnë automjetin me të cilin kryhet transporti “ taksi” duhet të ketë së paku 5 vite përvojë në drejtimin e automjeteve (sipas ligjit).

Neni 19

Kushtet për lëshimin e lejes taksi

1. Personi i cili dëshiron të pajiset me leje pune taksi përpos kushteve të parapara me nenin, 16, 17 dhe 18 duhet ti plotësojnë edhe këto kushte;
 - 1.1.te jete banor i Komunës së Shtimes;
 - 1.2.te ketë të regjistruar veprimtarinë taksi;
 - 1.3.te ketë aftësi shëndetësore (posedimi i certifikatës mjekësore me afatin e parapare me ligj);
 - 1.4. te ketë automjet në pronësi;
 - 1.5.Te jete në gjendje të rregullt teknike (verifikimin 6-mujor të parapare sipas ligjit).
 - 1.6.Te ketë aparatën kundër zjarrit (te vërtetuar-verifikuar 6-mujor).
2. Para se të lëshohet leja për këtë veprimtari, komisioni i formuar nga DSHP hartohet procesverbalin për plotësimin e kushteve për lëshimin e lejes taksi.
3. Automjeti i licencuar detyrohet ta ketë shenjen Taxi mbi automjet dhe në të dy anët e automjetit (në anën e majte dhe të djathtë).
4. Numri i lejeve për ushtrimin e veprimtarisë taksi lëshohen bazuar në numrin e kërkesave dhe plotësimit të kushteve të kërkuara;
5. DSHP dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi obligohen të caktojnë vendin ku operatorët Taksi duhet të qëndrojnë, dhe nisjes e bëjnë sipas radhës.

Neni 20

Ushtrimi i veprimtarisë taksi

1. Veprimtaria me auto-taksi mund të ushtrohet edhe nga operatori i cili ka një e më shumë automjete dhe i plotëson kushtet për operim si:
 - 1.1.Te jete i regjistruar sipas Ligjit ;
 - 1.2.Te ketë selinë brenda territorit të komunës;
 - 1.3. Te ketë numrin e nevojshëm të personelit (drejtuesit e automjeteve të plotësojnë kriterin sipas nenit 18 të kësaj rregulloreje).
2. Leja për shtrimin veprimtarisë taksi lëshohet për pesë (5) vite me mundësi vazhdimi.

Neni 21

Transporti për nevoja vetanake

1. Transporti për nevoja vetanake të udhëtarëve janë operacione që kryhen për qëllim jo-komercial dhe jo-fitimprurës nga një person fizik ose juridik, për të cilat:
 - 1.1. Aktiviteti i transportit është vetëm një veprimtari ndihmëse për atë person fizik ose juridik, si dhe
 - 1.2. Mjetet e përdorura janë prone e atij personi fizik ose juridik ose kanë qenë objekt i një kontrate mbi qiranë dhe drejtohen nga një anëtarë i stafit të personit fizik ose juridik ose personeli i punësuar nga vete ai, ose të vënë në dispozicion të ndërmarrjet në një detyrim të kontraktuar.
2. Operatori transportues, personi fizik apo juridik, mund të kryej transport për nevoja vetanake dhe transportin e punëtorëve të vet, ose personave të tjerë që kryejnë veprimtarinë e tyre, si dhe transportin e anëtarëve të familjeve të punëtorëve kur shkojnë në pushim apo rekreacion.
3. Transporti i udhëtarëve për nevojat vetanake, në kuptimi të kësaj rregulloreje, konsiderohet edhe transporti i personave, të cilin e bëjnë:
 - 3.1 ndërmarrjet hoteliere, personat tjerë juridikë dhe fizik, të cilët kryejnë veprimtari hoteliere;
 - 3.2 institucionet shëndetësore dhe ato të mbrojtjes sociale që bartin të sëmurët;
 - 3.3 agjencitë turistike, personat tjerë juridikë e fizikë, të cilët kryejnë veprimtari turistike dhe në baze të kontratës së veçante të transportit, transportojnë grupe turistesh pa pranimin dhe zbritjen e udhëtarëve gjatë rrugës;
 - 3.4 shoqata kulturore, sportive dhe shoqatat tjera që transportojnë nxënës, studente, personel mësimor ose anëtarët e tyre;
 - 3.5 autoshkollat, të cilat aftësojnë kandidatet për vozitës gjatë punës së tyre;
 - 3.6 operatorët transportues ose punëtorët, të cilët kryejnë shërbime të veçanta;
 - 3.7 operatorët për shërbime të aeroportit ose shoqatat tjera të shërbimeve të aeroportit, nëse kryejnë transportin e udhëtarëve nga vendosja e tyre deri te aeroporti dhe anasjelltas.
4. Në autobusin me të cilin kryhet transporti për nevoja vetanake, duhet të jetë i plotësuar regjistri i punëtorëve ose personave të tjerë, i vërtetuar nga pronari (transportuesi);
5. Në këndin e djathtë, të poshtëm, të xhamit mbrojtës të autobusit me të cilin kryhet transporti i udhëtarëve për nevoja vetanake, vendoset mbishkrimi “Transport për nevoja vetanake”.

Neni 22

Kushtet për automjetet e transportit të udhëtarëve (autobusëve)

1. Të gjithë autobusët me të cilët kryhet transporti publik i udhëtarëve, duhet të jenë të regjistruar dhe teknikisht në rregull, sipas dispozitave ligjore.
2. Autobusi me të cilin kryhet transporti publik duhet të ketë:
 - 2.1. Firmën, respektivisht emërimin e transportuesit, në pjesën anësore;
 - 2.2. Numrin e linjës me kohën e nisjes dhe kohën e arritjes, ose intervalin e lëvizjes në stacionin e fundit, të vënë në këndin e poshtëm të djathtë të xhamit mbrojtës;

- 2.3.Orarin e udhëtimit dhe çmimoren e transportit, te vendosura ne vend te dukshëm, dhe mbishkrimin për ndalimin e pirjes se duhanit.
3. Autobusi duhet t'i plotësoj te gjitha kushtet higjiene-teknike, te përcaktuara me ligj.
 4. Kur autobusi nuk bene transportin e rregullt te udhëtarëve, ne këndin e majte te xhamit mbrojtjes vihet mbishkrimi përkatës “Garazh” apo “Defekt”.
 5. Gjate sezonit te dimrit, para fillimit te punës ne linjën e caktuar, autobusi duhet te ngrohet.

Neni 23

Linjat e transportit rrugor

1. Transporti rrugor i udhëtarëve kryhet me linja te përhershme, për çdo dite dhe gjate tere viti apo ne periudhe te caktuar te vitit.
2. Linjat komunale te transportit rrugor te udhëtarëve, hapen në përputhje me Planin e transportit rrugor lokal.
3. Linjat e transporti publik në Shtime:
 - 3.1. Shtime - Lagja e Pajtimit – Godanc i Poshtëm – Godanc i Epërm dhe anasjelltas;
 - 3.2. Shtime – Davidovc – Gjyrkovc – Myzeqinë – Vojnovc dhe anasjelltas;
 - 3.3. Shtime - Davidovc – Rashincë – Gllavicë dhe anasjelltas;
 - 3.4. Shtime – Ura e Pashës – Raçak dhe anasjelltas;
 - 3.5. Shtime – Ura e Pashës – Petrovë – Mollopolc dhe anasjelltas;
 - 3.6. Shtime – Belinc – Carralevë – Pjetërshticë dhe anasjelltas;
 - 3.7. Shtime – Zborc dhe anasjelltas;
 - 3.8. Shtime – Koshare dhe anasjelltas;
 - 3.9. Shtime – Hani dhe anasjelltas;
4. Sipas kërkesës, nevojës dhe kësaj rregullore ekziston mundësia që me Vendim të DSHP-së të hapen vija të reja për vendbanime tjera të Komunës së Shtimes ne përputhje me Planin e transportit rrugor lokal.

Neni 24

Stacioni i autobusëve

1. Stacioni i autobusëve është objekt me infrastrukturën e saj përcjellëse për pranimin dhe përcjelljen e autobusëve sipas rendit te udhëtimit, hyrjen dhe zbritjen e udhëtarëve, shitjen dhe rezervimin e biletave për udhëtarë, gardërobën, pajisjet për informimin e udhëtarëve dhe operatoreve te transportit si dhe shërbimet tjera.
2. Transportuesi është i obliguar te ndalet ne te gjitha vend-ndaljet, te cilat i ka te regjistruara ne rendin e udhëtimit.

Neni 25

Vend-ndaljet

1. DSHP-ja e cakton numrin e vend ndaljeve qe janë te destinuar per kryerjen e shërbimeve te transportit rrugor për gjate linjës se caktuar komunale.
2. Vend-ndaljet e autobusëve ne linjat e përhershme i cakton DSHP-ja me planin e transportit rrugor.
3. Vend- ndaljet ne linjat komunale duhet te jene te rregulluar dhe te shënuara, doemos duhet të kenë sipërfaqe përkatëse te trafikut për ndaljen e automjetet, sipërfaqen per hyrjen dhe daljen e udhëtarëve dhe shenjat e bus-stacionit.
4. Ne rrugët publike, sipërfaqja per ndaljen e automjetit parimisht duhet te jete e ndërtuar jashtë shiritit te rrugës, ne pjese te ndare te rrugës.
5. Sipërfaqja qe shfrytëzohet për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve nga automjet, ne rruge apo vendbanim, duhet te jete e shtruar me asfalt, pllaka ose te jete e betonuar.
6. Për rregullimin e stacioneve dhe vend-ndaljeve, mirëmbajtjen dhe vendosjen e shenjave, kujdeset DSHP-ja.
7. Drejtoria mund te beje shkëputjen ose transferim te vend-ndaljes, nëse kjo është ne interes te organizimit me te mire dhe te sigurisë ne trafik.

Neni 26

Rendi ne stacione, vend-ndaljet dhe ne automjet

1. Automjetet patjetër duhet te ndalen ne te gjitha stacionet, përkatësisht vend-ndaljet e linjave te tyre.
2. Nëse automjeti nuk ka vende te lira, personeli i automjetit ka për detyre t'i njoftoje udhëtarët.
3. Personeli i automjetit obligohet të jep:
 - 3.1.sinjalin për nisjen dhe ndaljen e automjetit;
 - 3.2. hapjen dhe mbylljen e dyerve te automjetit;
 - 3.3.Nuk duhet te japë shenje për nisje, deri sa te konstatoje sa janë mbyllur dyert për hyrje dhe për dalje.
4. Drejtuesi i automjetit ne transportin linejor te udhëtarëve, nuk mund te ndale-parkoje automjetin ne bus-stacionin e shënuar me gjate se 3 minuta.
5. Derisa automjeti është ne lëvizje, dyert patjetër duhet te jene te mbyllura
6. Udhëtarët hyjnë ne automjet përmes dyerve te shënuara për hyrjen dhe zbresin përmes dyerve te shënuara për dalje
7. Personat me aftësi te kufizuara fizike, gratë shtatzëna, personat me fëmije deri ne 5 vjeç, inspektoret e trafikut, policet ne uniforme dhe personat me autorizime te veçanta, mund te hyjnë ne dyert e daljes.
8. Për shfrytëzimin e shërbimeve te transportit, udhëtari detyrohet te ketë biletën e udhëtimit, biletën e parapagimit apo leje tjetër valide te udhëtimit.
9. Udhëtari është i detyruar te tregoj biletën përkatëse te udhëtimit, sipas kërkesës se personit te autorizuar nga operatori i transportit, respektivisht nga inspektori i transportit rrugor.

10. Udhëtari, i cili është gjetur, përkatësisht që gjendet pa bilete udhëtimi në automjet, është i obliguar që, me kërkesë të personit të autorizuar, të bëjë kompensimin e biletës dhe gjohën në lartësi të dhjetëfishit të çmimit të biletës.
11. Nëse udhëtari refuzon të bëjë pagesën, të përshkruar në paragrafin paraprak, detyrohet që personit të autorizuar t'i ofrojë të dhënat e sakta për identitetin vet.
12. Udhëtari i cili dëmton apo ndot automjetin, është detyruar të kompensojë dëmin përkatësisht të paguajë pastrimin e tij.
13. Nëse udhëtari refuzon ta bëjë kompensimin, përkatësisht pagesën sipas paragrafit paraprak, është i detyruar që personelit të automjetit t'ia ofrojë të dhënat e sakta për identitetin e vet.
14. Udhëtari mund të futë në automjet: bagazhin e dorës, karrocën e mbledhur të fëmijëve, pushkën e gjahut ose të sportit me këllëf, skitë dhe kompletin për peshkim.
15. Në automjet, në pjesën ndihmëse, mund të futen qentë zyrtarë dhe qentë cicerone të personave të verbër, me shportë në gojë.
16. Gjerat e gjetura në automjet i dorëzohen personelit të automjetit i cili për këtë lëshon vërtetim me përshkrimin e shkurtër të sendeve të gjetura. Nëse pronari i gjësëve të gjetura nuk gjendet gjatë vozitjes, personeli i automjetit ato ia dorëzon menjëherë shërbimit përkatës të transportuesit.
17. Transportuesi detyrohet që gjësendet e gjetura, në afat prej 7 ditësh t'ia dorëzojë Policisë.

Neni 27

Ndërprerja e trafikut

1. Në rast të ndërprerjes së trafikut apo prishjes së automjetit, personeli është i detyruar që udhëtarëve t'ua sigurojë daljen e sigurtë nga automjeti.
2. Në rastet e prishjes së automjetit, nga paragrafi paraprak, transportuesi ka për obligim që udhëtarëve t'ua mundësojë vazhdimin e udhëtimit me automjet tjetër me të njëjtat bileta.

Neni 28

Veprimet që ndalohen në automjet

1. Gjatë transportit, ndalohet :
 - 1.1. Pengimi i personelit të automjetit në kryerjen e detyrës;
 - 1.2. Pirja e duhanit në automjet;
 - 1.3. Futja e kafshëve në automjet, përveç në rastet nga neni 26 paragrafi i 15 i kësaj rregulloreje;
 - 1.4. Hyrja në automjet me armë, përveç personave të autorizuar;
 - 1.5. Futja në automjet e gjësëve, të cilat mund të lëndojnë, dëmtojnë, ndotin, shqetësojnë udhëtarët ose dëmtojnë automjetin;
 - 1.6. Futja në automjet materialeve ndezëse dhe mjeteve eksplozive;
 - 1.7. Hyrja në automjet në gjendje të dehur;

- 1.8. Shqetësimi i udhëtarëve me këndin, me muzike, me britme, me shprehje e sjellje te pandërgjegjshme;
 - 1.9. Hedhja e mbeturinave dhe pështymja ne automjet;
 - 1.10. Hyrja ne automjet pas vërejtjes se personelit se nuk ka vende te lira.
2. Udhëtari i cili edhe pas vërejtjes, kryen ndonjëren nga veprimtarit e cekura ne ketë nen, largohet nga automjeti.

KREU III

TRANSPORTI RRUGOR I MALLRAVE

Neni 29

Transporti rrugor i mallrave

1. Transporti rrugor i mallrave kryhet si transporti mallrave për nevoja vetanake për llogari te vet dhe transportim i mallrave me qira dhe pagese (për pale te treta)
2. Gjate transportit te mallrave, operatori ne automjet duhet t'i ketë këto dokumente:
 - 2.1. Licencën dhe
 - 2.2. Fletëngarkesën
3. Ndalohet qarkullimi i automjeteve që transportojnë mallra me peshë mbi 7 Ton në zonën urbane (Rruga “Adem Jashari”, “Komandant Kumanova” dhe “Tahir Sinani”)
4. DSHP, mund të lëshoj Leje apo Autorizim të përkohshëm për automjete te caktuar me peshë mbi 7 Ton, pas pagesës se tarifës përkatëse, për rastet specifike, punimet ne Projekte Kapitale, rrënime, ndërtime, apo raste si këto.

Neni 30

Transporti i mallrave për nevoja vetanake

1. Transporti i mallrave për nevoja vetanake konsiderohet transporti te cilin e kryen personi fizik apo juridik pa kompensim.
2. Pa qene i regjistruar si transportues, ndalohet marrja me transport për nevoja vetanake
3. Transporti i mallrave me qira dhe pagese (për pale te treta) kryhet ne baze te marrëveshjes me shkrim ose me goje ne mes te dërguesit dhe marrësit te mallit i cili kontraktin transportin e mallit.
4. Emri dhe natyra e biznesit duhet te deklarohen kur te regjistrohet veprimtaria e transportit te mallrave për nevoja vetanake.
5. Regjistrimi nuk do te jete i efektshëm derisa aplikuesi te tregojë se transporti i mallrave për te cilin është kërkuar regjistrimi, mund te emërtohet si transporti i mallrave për nevoja vetanake.

Neni 31

Transporti i mallrave me qira dhe pagese

1. Transporti i mallrave me qira dhe pagese kryhet ne baze te Kontratës se lidhur ne mes te qiradhënësit te automjetit transportues dhe qiramarrësit, i cili kontraktton transportin e mallrave.
2. Gjate transportit te mallrave me qira dhe pagese, operatori i transportit ne automjet duhet te ketë:
 - 2.1.Fletëngarkesën dhe
 - 2.2.Kantatën ne mes te qiramarrësit dhe qiradhënësit

KREU IV

MBIKEQYRJA

Neni 32

1. Mbikëqyrja ne transportin rrugor brenda territorit te komunës, e bene DSHP-ja, Inspeksioni dhe Policia e Kosovës.
2. Inspeksioni i trafikut rrugor dhe Policia e Kosovës është autorizuar qe:
 - 2.1.Te beje kontrollin e operateve te transportit rrugor për ushtrimin e kësaj veprimtarie ne pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, ne baze te licencave dhe lejeve, te vërtetoje identitetin e operatorit transportues , personelit vozitës dhe te personave te tjetër përgjegjës për kryerjen e transportit;
 - 2.2. Te urdhëroje mënjanimin e lëshimeve dhe mungesave ne aspektin e plotësimit te kushteve te përcaktuara me këtë rregullore për kryerjen e transportit te udhëtarëve dhe te mallrave;
 - 2.3.Te përjashtojë nga qarkullimi automjetin, me te cilin kryhet transporti ne kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe te kësaj rregulloreje, te caktojë vend-parkimin, t’ia marre lejen e qarkullimit dhe targat ne kohëzgjatje prej 48 orësh.
3. Nëse te njëjtit operator te transportit i shqiptohet masa e gjobës mandator për here te dyte, për shkaqet e përcaktuara ne paragrafin 2, nënparagrafi 2.3 te këtij neni, automjeti do te përjashtohet nga qarkullimi ne kohëzgjatje deri ne 5 dite.
4. Me rastin e përjashtimit te automjetit taksi, atij i merret shenja “TAXI” dhe numri i evidencës i regjistrimit te qarkullimit.
5. Me kalimin e afatit te masës, nga paragrafi 2, nënparagrafi 2.3 dhe paragrafi 3 i këtij neni, inspektori ia kthen operatorit dokumentet dhe targat e marra, qofte vete apo përmes organi i cili ka lëshuar këto.
6. Kur inspektori i përjashton automjetin nga qarkullimi, merr vendim qe automjeti i ndaluar te dërgohet, ne shpenzime te mbajtësit te licencës , ne vende te caktuara për këto raste.

KREU V

DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 33

1. Operatori i transportit, përkatësisht personi tjetër Juridik apo fizik për kundërvajtje do te ndëshkohet me gjobe prej tetëqind (800) deri ne njëmijë (1.000) euro, ne qofte se:
 - 1.1. ushtron veprimtarinë e transportit publik pa licence neni 4 (paragrafi 1);
 - 1.2. ushtron veprimtarinë e transportit te udhëtarëve pa licence, pa rend te udhëtimit neni 5 dhe 8;
 - 1.3. nëse vepron ne kundërshtim me neni 24 (paragrafi 2).
2. Nëse operatori i transportit, përkatësisht personi tjetër juridik apo fizik bënë përsëritje te kundërvajtjes se njëjtë, përveç dënimit me gjobe, do t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës se ushtrimit te veprimtarisë se transportit ne kohëzgjatje prej 6 deri ne 12 muaj.
3. Operatori i transportit, përkatësisht personi tjetër Juridik apo fizik për kundërvajtjes do te ndëshkohet me gjobe prej pesëqind (500) deri shtatëqind (700) euro , ne qofte se:
 - 3.1. nuk mbanë linjën sipas rendit te udhëtimit, te vërtetuar dhe te regjistruara sipas neni 6, paragrafi 1;
 - 3.2. ndryshon rendin e udhëtimit, ndërpret përkohësisht transportin dhe nuk e paraqet ndërprerjen neni 15, paragrafi 7 dhe 8;
 - 3.3. bene transportin e veçante te udhëtarëve ne kundërshtim me nenin 14, paragrafi 1,2,3,
 - 3.4. bene transportin për nevoja personale ne kundërshtim me nenin 21;
 - 3.5. vepron ne kundërshtim me nenin 8, paragrafin 3;
 - 3.6. vepron ne kundërshtim me nenin 15, paragrafi 1.
4. Kundërvajtje te njëjta qe transportuesi, përkatësisht personi Juridik apo fizik i përsërit, përveç dënimit me gjobe, do t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës se ushtrimit te veprimtarisë se transportit, ne kohëzgjatje prej 6 deri 12 muaj.
5. Operatori i transportit, përkatësisht personi tjetër Juridik apo fizik për kundërvajtje do te ndëshkohet me gjobe prej njëqind (100) deri ne treqind (300) euro:
 - 5.1. vepron ne kundërshtim me nenet 11 dhe 12;
 - 5.2. vepron ne kundërshtim me nenin 15, paragrafi 5,9,10 dhe 13;
 - 5.3. vepron ne kundërshtim me nenet 16, 17 dhe 18;
 - 5.4. vepron ne kundërshtim me nenin 26, paragrafi 4,5,8 dhe 9;

1.6. vepron ne kundërshtim me nenet 30 dhe 31.

Neni 34

Të gjitha çështjet e tjera të cilat nuk janë paraparë në këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e ligjit për transportin rrugor të Kosovës.

Neni 35

Përgjegjësit për zbatim

Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Gjeodezi dhe Inspekcioni i transportit dhe Policia e Kosovës.

Neni 36

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet rregullorja mbi transportin publik të udhëtarëve dhe mallrave të Komunës së Shtimes Nr. 01/75/2 të datës 26.05.2003.

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj
